



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



ZGJEDHJET LOKALE

22 tetor 2017

PERIUDHA PËR NDËRRIMIN E QENDRAVE TË VOTIMIT 26 Korrik – 12 Shtator

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës është duke bërë përgatitjet për organizimin e Zgjedhjeve Lokale, të cilat do të mbahen më **22 tetor 2017**.

Votuesit do të kenë mundësi të informohen dhe t'i kontrollojnë të dhënat e tyre në lidhje me Qendrën e tyre të Votimit në Zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në Komunën e tyre, ose në ueb-faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org, në linkun “Ku do të votosh”.

Qytetarët mund t'i drejtohen Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, i cili do t'u ofrojë sqarime dhe përgjigje në pyetjet si:

- **A kam të drejtë të votoj?**

Ju keni të drejtë të votoni nëse emri juaj gjendet në **Listën Votuese** dhe jeni nga mosha **18-vjeçare** më **22 tetor 2017**.

- **Ku duhet të votoj?**

Vizitoni Komisionin Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj, ose ueb-faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org, në linkun “Ku do të votosh” për t'u informuar se në cilën Qendër të Votimit ju mund të votoni.

- **Si ta ndërroj Qendrën e Votimit?**

Për të ndërruar Qendrën e Votimit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u mundëson përmes aplikacionit online, që është vendosur në ueb faqen e KQZ-së www.kqz-ks.org ku në anën e djathtë klikoni në linkun “Ku do të votosh?”.

Aplikacioni online ju mundëson informacione se në cilën Qendër të Votimit jeni caktuar që të votoni dhe gjithashtu ju mundëson ndërrimin e qendrës së votimit.

Ndërrimin e Qendrës së Votimit mund ta bëni edhe në zyrën e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, duke plotësuar formularin për ndërrim të Qendrës së Votimit.